



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:085578  
Datë: 20.06.2024  
Numri i dokumentit: 05840145

**K.Dh.Sh II.nr.61/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Gjakova”, SH.A., me seli në Gjakovë, rruga “UÇK”, nr.7, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Rexhep Grubi nga Gjakova, kundër debitorit “Prokuroria Komunale - Gjakovë”, rruga “Nëna Terezë” p.n përfaqësuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1822/22 të datës 17.08.2023, me datë 20.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Gjakova”, SH.A., me seli në Gjakovë ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1822/22 të datës 17.08.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1822/22 të datës 17.08.2023, në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit “Prokuroria Komunale - Gjakovë”, ashtu që është anuluar Urdhri Përmbarrimor P.nr.223/22 të datës 02.03.2021, të Përmbarruesit Privat Gëzim Gjoshi dhe ka përfunduar në tërësi përmbarrimi në këtë çështje përmbarrimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1822/22 të datës 17.08.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar debitori nëpërmjet të cilës ka kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë që ankesën e kreditorit ta refuzoj si të pabazuar dhe ta vërtetoj aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1822/22 të datës 17.08.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale Ujësjellësi “Gjakova”, SH.A., me seli në Gjakovë, ka paraqitur propozimin për përmbarrim në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave të viteve 2006-2010, ku e ka urdhëruar debitorin “Prokuroria Komunale - Gjakovë”, që brenda afatit prej 8 ditësh pas pranimit të aktvendimit, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 533.15 €, me kamatë ligjore prej 3.5% nga dita e parashtrimit të propozimit për përmbarrim e deri në ditën e pagesës si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Kundër urdhrorit për lejimin e përmbarrimit, debitori ka paraqitur prapësim në të cilin ka deklaruar se në periudhën 2006-2010 nuk ka qenë në fuqi Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës

prandaj përgjegjëse për pagesa në këtë periudhë ka qenë Ministria e Drejtësisë. Tutje thekson se urdhri është i metë pasi që nuk përmban pjesën e këshillës juridike e drejtë e cila garantohet me Ligjin për Procedurën Përmbartimore. Ne vazhdim ka deklaruar se nuk janë ndjekur procedurat sipas Rregullores Financiare Nr.01/2013 për shpenzimin e parasë publike respektivisht kreditori nuk ka ndjekur rrugët ligjore për të arkëtuar të hyrat nga faturat. Andaj i propozon Gjykatës ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta refuzoj urdhrin dhe precizimin e Urdhrit Përmbartimor P.nr.223/22.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ndër të tjera ka theksuar se prapësimi duhet të hedhet poshtë si i pa afatshëm si dhe sa i përket pretendimeve të debitorit rreth mungesës të legjitimitetit pasiv nuk qëndrojnë sepse si pasardhëse juridike “Prokuroria Komunale e Gjakovës” i bart të gjitha obligimet lidhur me shpenzimet e krijuara ndaj kreditorit. Tutje thekson se parashkrimi në këtë rast nuk vjen në konsideratë pasi që debitori është person juridik dhe shpenzimet komunale parashkruhen në periudhë 3 vjeçare. Duke u bazuar në të lartcekurat i propozon Gjykatës ta refuzoj në tërësi prapësimin si të pabazuar.

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1822/22 të datës 17.08.2023, ku në dispozitiv të aktvendimit e ka e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit “Prokuroria Komunale - Gjakovë”, ashtu që është anuluar Urdhri Përmbartimor P.nr.223/22 të datës 02.03.2021, të Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi dhe ka përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka gjetur se e faturat që gjenden në shkresat e lëndës nuk janë origjinale apo të vërtetuara tek organi kompetent, siç përcaktohet në dispozitën e nenit 37 të LPP-së, dhe si të tilla nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm dhe nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore

nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumenteve të lëshuara nga kreditori, e të cilat dokumente nuk përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Ndërsa me nenin 37 të LPP-së është përcaktuar se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*e që në rastin konkret faturat nuk janë në origjinal apo të vërtetuar tek organi kompetent siç kërkohet më dispozitën e lartë cekur.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin ngase propozimit për përmbarim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumenteve përmbimore.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet ankimore, lidhur me atë se propozimi është paraqitur me ligjin e vjetër Ligji.nr.03/L-008 dhe se nuk ka qenë e specifikuar se faturat të jenë kopje apo në origjinal, një pretendim të tillë kjo gjykatë e refuzoj si të pa bazuar për shkak se ligji nr.04/L-139 në nenin 402 e ka shfuqizuar ligji e procedurës përmbimore të vitit 2008 gjegjësisht me nr.04/L-008, por edhe sikur të miret parasysh ligji i vjetër edhe ky ligj në nenin 38 ka paraparë se; *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar”*, andaj faturat në fjalë nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm dhe se nuk i ka tiparet e përmbarueshmërisë, kështu kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendime tjera, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë**

K.Dh.Sh II.nr.61/24 me datë 20.06.2024

**Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija Ymeri**